

REPublika e Kosovës
REPublika KOSOVA
REPUBLIC OF KOSOVO
KOMUNA • OPSTINA • MUNICIPALITY
HANI I ELEZIT

Nr. i Prot. 04/8348
Nr. i Faq. _____ Data 02.10.25



REPUBLIKA E KOSOVËS-REPUBLIC OF KOSOVO
KOMUNA - MUNICIPALITY
HANI I ELEZIT



Nr. 04/ 8348 /2025

**Raporti nga procesi i organizimit të dëgjimeve buxhetore për projekt
buxhetin e komunës për vitin 2026 dhe parashikimet buxhetore për
vitet 2027-2028**

Tetor, 2025

1. Hyrje

Buxheti i komunës së Hanit të Elezit është një plan fiskal që përcakton të hyrat dhe shpenzimet e parashikuara për të udhëhequr shërbimet dhe politikat që zbatohen gjatë vitit fiskal 2026. Ai përcakton bazat për ato që do të jenë qëllimet dhe arritjet e komunitetit tonë.

Buxheti i propozuar do të vazhdojë të arrijë prioritetet afatmesme të komunës siç janë aprovuar në qershor 2025 me Kornizën Afatmesme Buxhetore 2026-2028. Ju do të shihni se këtyre prioritetëve do t'i referohem përgjatë këtij dokumenti, i cili është hartuar nga grupi punues si dhe kryesisht reflekton kërkesat e qytetarëve/eve, siç paraqiten gjatë dëgjimeve publike buxhetore, të organizuara nga ekzekutivi dhe legjislativi komunal.

Buxheti i vitit 2026 pasqyron përpjekjen tonë të vazhdueshme për të ofruar shërbime arsimore cilësore në nivelin parashkollor, fillor dhe të mesëm; shërbime shëndetësore, si dhe zhvillim të mëtutjeshëm të infrastrukturës që do të japë kontribut drejt zhvillimit të komunës së Hanit të Elezit. Për t'i zbatuar prioritetet e mësipërme, buxheti për vitin fiskal 2026 ka përfshirë gamën e plotë të operacioneve dhe programeve komunale të cilat i përfshijnë të mëposhtmet:

1. Zyra e Kryetarit,
2. Administrata dhe Personeli,
3. Zyra e Kuvendit Komunal,
4. Buxheti dhe Financat,
5. Shërbimet Publike, Emergjencia dhe Mbrojtja Civile,
6. Zyra për Komunitete dhe Kthim,
7. Bujqësia, Pylltaria dhe Zhvillimi Rural,
8. Zhvillimi Ekonomik dhe Turizmi,
9. Planifikimi Urban dhe Inspeksioni,
10. Shëndetësia dhe Mirëqenia Sociale,
11. Arsimi dhe Shkenca dhe
12. Kultura, Rinia dhe Sporti.

Programet e komunës vazhdojnë ta pasqyrojnë qëllimin tonë për ta përmirësuar cilësinë e jetës së qytetarëve/eve tanë/tona, shoqëruar me një menaxhim të shëndoshë dhe financiar.

Gjatë fazave të hershme të planifikimit të buxhetit kemi formuar grupin punues për hartimin e buxhetit si dhe kemi bërë planin e dëgjimeve buxhetore. Fokusi ynë ka qenë i përqëndruar të arrijmë tek çdo qytetarë/e pa dallim. Rrjedhimisht, kemi mbajtur dëgjimeve buxhetore me grupe të ndryshme të interesit, të cilat i gjeni të listuara në vijim.

2. Ecuria e procesit të dëgjimeve buxhetore për projekt buxhetin e vitit 2026

Fillimisht, nga Kryetari i Komunës u themelua grupi punues për hartimin e buxhetit si dhe grupi punues për organizimin e dëgjimeve buxhetore.

Në planin e dëgjimeve buxhetore është specifikuar çdo detaj, duke filluar nga:

1. Aktivitetet para-përgatitore,
2. Aktivitetet Kryesore,
3. Masat që duhet të ndërmerren,
4. Staf i përgjegjës dhe staf i përkrahës/suportues,
5. Korniza kohore (Vendi dhe koha) dhe
6. Veprimet e ndërmarra.

<https://haniielezit.rks-gov.net/wp-content/uploads/2025/08/Plani-i-veprimit-te-degjimeve-buxhetore-per-Draft-Buxhetin-2026-2028.pdf>

- Orari/kalendari i dëgjimeve buxhetore për Draft Buxhetin 2026-2028:

<https://haniielezit.rks-gov.net/wp-content/uploads/2025/07/Kalendari-i-degjimeve-buxhetore-per-Draft-Buxhetin-2026-2028.pdf>

- Njoftimet e dëgjimeve, (te ky link nëpër faqe të ndryshme janë njoftimet e dëgjimeve):

<https://haniielezit.rks-gov.net/news/ftese-19/>

- Te ky link janë të publikuara fotografitë e dëgjimeve buxhetore të mbajtura:

<https://haniielezit.rks-gov.net/news/mbahet-degjimi-i-dyte-buxhetor-per-draft-buxhetin-2026-2028-i-dedikuar-per-bizneset-dhe-ojq-te/>

3. Paraqitja tabelare e Kapitullit I

Përmbajtja	Përshkrimi	Shtesë / Link
Formimi i Grupit Punues	Data e formimit të grupit që ka planifikuar dhe organizuar konsultimet publike për projekt-buxhetin 2026.	(Të përfshihet data specifike në dokumentin përfundimtar)
Përgatitja e Planit dhe Kalendari i Konsultimeve	Data: 04.08.2025	 https://hannielezit.rks-gov.net/wp-content/uploads/2025/08/Plani-i-veprimit-te-degjimeve-buxhetore-per-Draft-Buxhetin-2026-2028.pdf
Njoftimet për Konsultimet Publike	https://hannielezit.rks-gov.net/lajmet-2/	 https://hannielezit.rks-gov.net/lajmet-2/
Procesverbalet e Konsultimeve	https://hannielezit.rks-gov.net/korniza-afatmesme-buxhetore-kab/?tax=	 Procesverbali-i-degjimit-buxhetor-me-OJQ-dhe-Biznese-per-Draft-Buxhetin-2026-2028.pdf Procesverbali-i-Degjimit-buxhetor-me-Sektorin-e-Shendetesise-dhe-te-Arsimit-per-Draft-Buxhetin-2026-2028.pdf Procesverbali-i-degjimit-buxhetor-ne-fshatin-Paldenice-per-Draft-Buxhetin-2026-2028.pdf Procesverbali-i-Degjimit-Buxhetor-ne-Gorance-per-Draft-Buxhetin-2026-2028.pdf

		<u>Procesverbali-i-Degjimit-Buxhetor-ne-Secishte-per-Draft-Buxhetin-2026-2028.pdf</u> <u>Procesverbal-nga-Degjimi-Buxhetor-ne-Lagjen-e-Re-per-Draft-Buxhetin-2026-2028.pdf</u> <u>Procesverbali-i-degjimit-buxhetor-i-hapur-per-gjithe-qytetaret-per-Draft-Buxhetin-2026-2028.pdf</u> <u>Procesverbali-i-degjimit-buxhetor-me-Fermeret-per-Draft-Buxhetin-2026-2028.pdf</u> <u>Procesverbali-i-Degjimit-Buxhetor-me-Grate-per-Draft-Buxhetin-2026-2028.pdf</u> <u>Procesverbali-i-degjimit-buxhetor-me-Handikos-per-Draft-Buxhetin-2026-2028.pdf</u>
Konsultimet me Mekanizmat Lokale	Në bashkëpunim me Drejtorinë e Administratës së Përgjithshme kemi njoftuar Kryetarët e Këshillave Lokal, paraprakisht të mbajnë takime me banorët e lokaliteve dhe të diskutojnë rreth kërkesave, nevojave dhe prioriteteve të tyre. Gjatë dëgjimeve buxhetore Kryetarët e Këshillave Lokal kanë dhënë propozimet e banorëve nga takimet paraprake. Megjithatë, pjesëmarrësit përsëri kanë pasur mundësi të japin rekomandime dhe propozime tjera.	Çdo administrator apo Kryetar i Këshillave Lokal ka përgatitur listën e projekteve të cilat janë më me prioritet për Lokalitetin e tyre. Në aneksin e mëposhtëm janë të adresuara kërkesat e tyre si dhe statusi i kërkesave me sqarimet e nevojshme.

Konsultimet nga Kryetari i Komunës	Janë mbajtur 10 dëgjime buxhetore të organizuara nga Kryetari i Komunës me grupe të ndryshme të interesit dhe nëpër lokalitete të ndryshme. Është bërë një gjithpërfshirje e qytetarëve/eve.	Në aneksin e mëposhtëm janë të adresuara kërkesat e tyre si dhe statusi i kërkesave me sqarimet e nevojshme.
Konsultimet e pranuar me shkrim	Gjatë periudhës së mbajtjes së dëgjimeve buxhetore për Draft Buxhetin 2026-2028 kemi pranuar një kërkesë në formë fizike për një projekt kapital dhe 2 kërkesa me anë të e-mailit.	Kërkesa e pranuar në formë fizike nga Egzon Bajramaliu më datë 11.07.2025 me Nr. 02/5166/2025. Kërkesa përfshin këtë propozim: Shtrim me kubëza të betonit në varrezat e fshatit Rezhancë. Kjo kërkesë është shqyrtuar nga Grupi Punues dhe ka hyrë në Listën e Projekteve Kapitale 2026-2028 në kuadër të projektit (i ri) "Shtrimi me kubëza betoni i rrugës që lidh fshatin Rezhancë me varrezat". Propozimi I parë me anë të e-mailit është nga Remzi Bushi më date 13.08.2025. Ka parashtruar dy propozime: 1. Rehabilitimin e rrugës Imer Vila në Fshatin Paldenicë me një gjatësi 320 m si dhe ndërtimi i kanalizimit atmosferik në këtë segment Rugorë, po ashtu në këtë segment rrugor mund të bëhet edhe vendosja e gypit të ujësjellësit të qytetit, për të furnizuar këtë zonë me ujë të pishëm. 2. Asfaltimi i Rrugës pranë Varrezave të Lagjës Bushi i Epërm me një Gjatësi 300 m. Statusi i kërkesës: Të pranuar dhe të buxhetuara në kuadër të

	këtyre projekteve: ” Ndërtimi (Rihapja, zgjerimi) dhe asfaltimi i rrugëve në fshatrat: Paldenicë, Pustenik, Seçishtë, Gorancë, Dimcë, Krivenik” si dhe “Rregullimi i prockave dhe kanalizimeve atmosferike në fshatrat: Paldenicë, Rezhancë dhe Seçishtë”. Kërkesa tjetër është nga Burim Suma, më datë 12.09.2025, e cila përfshin: Zgjerimi i trotuarit me shteg për biçikleta dhe hapësirë mbrojtëse, ose ndërtimi i një trotuari alternativ në anën tjetër të rrugës, nëse është e mundur. Statusi i kërkesës: Kjo kërkesë refuzohet duke qenë se trotuari është ekzistues dhe nuk ka hapësirë për zgjerim. Sa i përket ndërtimit të trotuarit nga ana tjetër e rrugës është e pamundur pasi që janë prona private dhe nuk kemi mjete të mjaftueshme për shpronësim. 3. Vendosja e vijave të bardha, apo mbikalim/nënkalin në zonat e banuara me rrezik të lartë, veçanërisht për nxënësit që kalojnë rrugën me trafik të dendur dhe rrezikshmëri të madhe. Kjo është një masë urgjente për parandalimin e ndonjë aksidenti të mundshëm. Statusi i kërkesës: Kjo kërkesë aprovohet dhe nga natyra i takon kategorisë Mallra dhe shërbime.
--	--

		3. Instalimi i paneleve akustike (6–10 metra lartësi) përgjatë trotuarit nga pika kufitare deri tek hyrja e fabrikës së çimentos Sharrcem, për të reduktuar zhurmën dhe ndotjen nga pluhuri industrial. Statusi i kërkesës: Kjo kërkesë është shqyrtuar nga Grupi Punues i Hartimit të Buxhetit, por për shkak të kostove të papërballueshme të implementimit Grupi Punues ka vendosur që ky propozim të shqyrtohet në vitet vijuese, duke qenë se ka kërkesa më prioritare për mirëqenien e komunitetit.
		4. Gjelbërimi përgjatë trotuarit, me drunj dhe pisha që i mbijetojnë zonës së ndotur, si dhe zbatimi i një plani afatgjatë për mirëmbajtje dhe ujitje. Statusi i kërkesës: Kjo kërkesë aprovohet dhe nga natyra i takon kategorisë buxhetore Mallra dhe Shërbime.
		5. Pastrimi dhe mirëmbajtja e rregullt e asfaltit të rrugës "Adem Jashari", duke eliminuar pluhurin dhe gurët që bien nga kamionët industrialë, për të rritur sigurinë dhe cilësinë e ambientit për qytetarët. Statusi i kërkesës: Kjo kërkesë refuzohet pasi që mirëmbajtja e rrugës "Adem Jashari" nuk është nën kompetencën e Komunës.

2. PËRMBLEDHJE TABELARE E KONSULTIMEVE TË MBAJTURA

Grupi i interesit / Me kë është mbajtur dëgjimi	Data dhe ora	Lokacioni	Nr. total i pjesëmar rësve	Gra	Burra	Persona me aftësi kufizuar	Nr. total i kërkesav e ¹	Investime Kapitale	Subvenci one	Mallra dhe Shërbime	Kërkesa për informacion / pyetje
Dëgjim Buxhetor i hapur për të gjithë qytetarët/et	08.08.2025 10:00	Salla e Takimeve, Objekti i Komunës	12	5	7	/	6	4	/	2	1
Dëgjim Buxhetor me bizneset dhe OJQ-të	11.08.2025, 10:00	Salla e Takimeve, Objekti i Komunës	12	5	7	/	1	1	/	/	1
Dëgjim Buxhetor me banorët/et e fshatit Paldenicë	11.08.2025 19:00	SHFMU “Kështjella e Diturisë”	8	2	6	0	1	1	/	/	1
Dëgjim Buxhetor me “Handikos”	12.08.2025 10:00	Salla e Takimeve, Objekti i Komunës	10	5	5	1	4	1	1	2	/
Dëgjim Buxhetor me banorët/et e fshatit Goranë	12.08.2025 19:00	SHFMU “Veli Ballazhi”	14	2	12	/	17	8	/	5	4

Dëgjim Buxhetor me Fermerët/et	13.08.2025 10:00	Salla e Takimeve, Objekti i Komunës	31	4	27	/	13	7	2	/	4
Dëgjim Buxhetor me Gratë	13.08.2025 14:00	Restaurant "Oslo"	21	21	/	/	10	2	4	1	3
Dëgjim Buxhetor me Sektorin e Arsimit dhe Shëndetësisë	14.08.2025 11:00	Salla e Takimeve, Objekti i Komunës	20	7	13	/	10	4	1	4	1
Dëgjim Buxhetor me banorët/et e fshatit Seçishtë	14.08.2025 19:00	SHFMU "Ilaz Thaçi"	10	3	7	/	7	6	/	1	/
Dëgjim Buxhetor me banorët/et e Lagjes së Re	15.08.2025 19:00	Shtëpia e pritjes në Lagje të Re	20	2	18	/	14	6	1	4	3

4. METODOLOGJIA DHE KRITERET PËR KLASIFIKIMIN E STATUSIT TË KËRKESAVE

Duke u bazuar në të gjithë kërkesat e pranuar nga pjesëmarrësit nëpër dëgjime buxhetore si dhe kërkesat në forma të tjera, adresimin e tyre e kemi klasifikuar në:

1. **Pranim/Aprovim:** nënkupton që kërkesa konkrete e qytetarit/es konsiderohet se është e nevojshme për tu realizuar dhe si e tillë do të jetë pjesë e buxhetit për vitin 2026. Pra kërkesat e tilla, si për projekte kapitale, subvencione apo mallra & shërbime janë pjesë e Buxhetit të miratuar në Kuvend Komunal.
2. **Adresim:** nënkupton që kërkesa e qytetarit/es adresohet te Subjekti, palët, Institucioni relevant. Kjo mund të jetë relevante psh kur kërkesat e qytetarëve nuk janë në kompetencën komunale dhe janë përgjegjësi/kompetencë e një insititucioni tjetër (si psh KEDS-it, Bifurkacionit, nivelit Qendror gjegjësisht Ministrinë e Linjës) dhe kur klasifikohet si e “Adresuar” nënkupton që Komuna do të adresoj apo ka adresuar kërkesën tek institucioni relevant.
3. **Pjesërisht e pranuar/aprovuar:** Këtu janë klasifikuar kërkesat e qytetarëve/eve të cilat mund të përfshijnë disa lloj intervenimesh (psh. Në kuadër të një propozimi ka disa kërkesa, prej të cilave disa mund të realizohen ndërsa të tjerat për arsye të ndryshme nuk do të realizohen). Në këto raste, Grupi Punues ka prioritetizuar segmente të kërkesës dhe si të tilla janë miratuar në Kuvend Komunal. Në këta raste, kërkesa mbetet pjesërisht e pranuar/aprovuar.
4. **E refuzuar:** Nënkupton kërkesat e qytetarëve/eve të cilat nuk përfshihen në buxhetin e komunës për vitin 2026. Kjo mund të jetë për shumë arsye siç janë: mungesën e mjeteve financiare, fakti që kërkesa nuk bënë pjesë në prioritetet komunale, fakti që kërkesa është më shumë e natyrës individuale se sa me ndikim në komunitet, fakti që për realizimin e kërkesës/investimit do të duhet fillimisht të mënjanohej probleme të ndryshme si shpronësimet apo fakti që menaxhimi i pronës nuk është në kompetencë komunale, etj.

**5. TABELARI I DETAJUAR SIPAS KATEGORIVE TË KËRKESAVE DHE
STATUSIT QË MARRIN**

INVESTIME KAPITALE			
Kërkesat, sugjerimet, idetë e parashtruara në konsultime	Emri i personit/organizatës	Statusi i kërkesës	Përgjigja dhe arsyeshmëria e komunës/grupit punues
1. Rregullimi i prrockave te Ramuktë dhe te Krasniqtë në fshatin Paldenicë	Amir Dernjani	Aprovuar	Grupi punues ka shqyrtuar këtë propozim dhe ka hyrë në Listën e Projekteve Kapitale për vitin 2026 si dhe është miratuar në Kuvend Komunal.
2. Asfaltimi dhe rregullimi i kanalizimit atmosferik në rr. Imer Vila	Remzi Bushi	Aprovuar	Grupi punues ka shqyrtuar këtë propozim dhe ka hyrë në Listën e Projekteve Kapitale për vitin 2026 si dhe është miratuar në Kuvend Komunal.
3. Ndërtimi i rrugës te varrezat e Lagjes Bushi të Epërm	Remzi Bushi	Aprovuar	Grupi punues ka shqyrtuar këtë propozim dhe ka hyrë në Listën e Projekteve Kapitale për vitin 2026 si dhe është miratuar në Kuvend Komunal.
4. Rritja e kapacitetit të ndriçimit publik prej te La Terraza deri te kufiri	Igballe Bushi	Aprovuar	Grupi punues ka shqyrtuar këtë propozim dhe ka hyrë në Listën e Projekteve Kapitale për vitin 2026 si dhe është miratuar në Kuvend Komunal.
5. Te vendosen disa shtylla ndriçuese te shenjat e këmbësorëve te Marketi Besa dhe Viva	Amir Berisha	Aprovuar	Grupi punues ka shqyrtuar këtë propozim dhe ka hyrë në Listën e Projekteve Kapitale për vitin 2026 si dhe është miratuar në Kuvend Komunal.
6. Asfaltimi apo shtrimi me kubëza betoni te Lagja Uji i Thartë tek familja e Halit the Tefik Bushit	Halit Bushi	Aprovuar	Grupi punues ka shqyrtuar këtë propozim dhe ka hyrë në Listën e Projekteve Kapitale për vitin 2026 si dhe është miratuar në Kuvend Komunal.
7. Rregullimi i rrugës Bypass	Këshilli i fshatit Gorancë	Adresuar	Grupi punues ka shqyrtuar këtë propozim dhe rregullimi i kësaj rruge përveç se ka kosto të lartë, fillimisht duhet të mënjanoen problemet e shpronësimit duke qenë se ai lokacion përfshin shumë parcela private
8. Rregullimi i rrugës që çon te Lapidari i Feriz dhe Xhevdet Guri	Këshilli i fshatit Gorancë	Adresuar	Implementimi i këtij propozimi ka kosto shumë të madhe. Do të shqyrtohet dhe adresohet kjo kërkesë për t'u realizuar me Bashkëfinancim me Ministri të Linjës apo me Donatorë.

9. Rregullimi i kanalizimit deri në fshatin Rezhancë	Këshilli i fshatit Gorancë	Aprovuar	Kërkesa është në përputhje me politikat komunale dhe do të realizohet në vitin 2026, ky propozim është miratuar në Kuvend Komunal.
10. Rregullimi i asfaltit dhe vendosja e pengesave të shtrira nëpër fshat	Këshilli i fshatit Gorancë	Aprovuar	Kërkesa është në përputhje me politikat komunale dhe do të realizohet në vitin 2026, ky propozim është miratuar në Kuvend Komunal.
11. Rregullimi i shëtitores Gorancë-Pisha-Hunel (kubëza, ndriçim, karrige, shtegu për biçiklistë)	Këshilli i fshatit Gorancë	Aprovuar	Kërkesa është në përputhje me politikat komunale dhe do të realizohet në vitin 2026, ky propozim është miratuar në Kuvend Komunal.
12. Afaltimi i rrugës Hunel-Te Pishat	Këshilli i fshatit Gorancë	Aprovuar	Kërkesa është në përputhje me politikat komunale dhe do të realizohet në vitin 2026, ky propozim është miratuar në Kuvend Komunal.
13. Asfaltimi i rrugës Gorancë – Pustënik	Këshilli i fshatit Gorancë	Aprovuar	Grupi punues ka shqyrtuar këtë propozim dhe ka hyrë në Listën e Projekteve Kapitale për vitin 2026 si dhe është miratuar në Kuvend Komunal.
14. Rregullimi i rrugës dhe pishinës te Gjura	Këshilli i fshatit Gorancë	Refuzuar	Grupi punues ka shqyrtuar këtë propozim por kjo kërkesë nuk bën pjesë në prioritetet e vitit 2026 për shkak të mundësive të limituara buxhetore.
15. Të hapen rrugët e thella rurale	Muhamed Suma	Aprovuar	Implementimi i këtij propozimi ka kosto shumë të madhe. Do të shqyrtohet dhe adresohet kjo kërkesë për t'u realizuar me Bashkëfinancim me Ministri të Linjës apo me Donatorë.
16. Hapja e rrugës Dermjak-Llokme dhe Krivenik-Te mullinjtë	Muhamed Suma	Aprovuar	Implementimi i këtij propozimi ka kosto shumë të madhe. Do të shqyrtohet dhe adresohet kjo kërkesë për t'u realizuar me Bashkëfinancim me Ministri të Linjës apo me Donatorë.
17. Rregullimi i ndriçimit publik kah kufiri	Zuli Kalisi	Aprovuar	Kërkesa është në përputhje me politikat komunale dhe do të realizohet në vitin 2026, ky propozim është miratuar në Kuvend Komunal.

18. Rregullimi i ndriçimit publik prej te La Terazza deri te kufini	Igballe Bushi	Aprovuar	Kërkesa është në përputhje me politikat komunale dhe do të realizohet në vitin 2026, ky propozim është miratuar në Kuvend Komunal.
19. Hapja e rrugave të thella sidomos rruga në Neçavc	Lumturije Bushi	Aprovuar	Kërkesa është në përputhje me politikat komunale dhe do të realizohet në vitin 2026, ky propozim është miratuar në Kuvend Komunal.
20. Shtimi i hapësirave për punë në QKMF	Bashkim Hazizi	Adresuar	Me PZHK parashikohet ndërtimi i një QKMF të re. E cila do të bëhet me bashkëfinancime me Organizata apo donatorë vendor apo të jashtëm.
21. Investimi dhe renovimi në AMF në Gorancë	Bashkim Hazizi	Aprovuar	Kërkesa është në përputhje me politikat komunale dhe do të realizohet në vitin 2026, ky propozim është miratuar në Kuvend Komunal.
22. Rehabilitimi i rrugës kah Vorbat	Mevludin Kuka	Aprovuar	Kërkesa është në përputhje me politikat komunale dhe do të realizohet në vitin 2026, ky propozim është miratuar në Kuvend Komunal.
23. Shtrimi me kubëza betoni te burimi	Mevludin Kuka	Aprovuar	Kërkesa është në përputhje me politikat komunale dhe do të realizohet në vitin 2026, ky propozim është miratuar në Kuvend Komunal.
24. Rregullimi i kanalizimit në Seçishtë	Mivet Kalisi	Aprovuar	Kërkesa është në përputhje me politikat komunale dhe do të realizohet në vitin 2026, ky propozim është miratuar në Kuvend Komunal.
25. Rregullimi i trotuarit për këmbësor në anën tjetër të Urës së Seçishtës	Mivet Kalisi	Adresuar	Kjo kërkesë është në përputhje me politikat komunale. Megjithatë, për t'u implementuar duhet të bëhet së pari një studim se sa e qëndrueshme është Ura për t'u shtuar edhe një aneks tjetër.
26. Rregullimi i ujësjellësit në fshatin Seçishtë	Ibush Shkreta	Aprovuar	Kërkesa është në përputhje me politikat komunale dhe do të realizohet në vitin 2026, ky propozim është miratuar në Kuvend Komunal.

27. Rregullimi i ndriçimit publik	Ibush Shkreta	Aprovuar	Kërkesa është në përputhje me politikat komunale dhe do të realizohet në vitin 2026, ky propozim është miratuar në Kuvend Komunal.
28. Rregullimi i kanalizimit të rruga “7 Marsi”	Nehat Xhoni	Aprovuar	Kërkesa është në përputhje me politikat komunale dhe do të realizohet në vitin 2026, ky propozim është miratuar në Kuvend Komunal.
29. Shtimi i kapaciteteve të ujit	Visar Hasallari	Aprovuar	Kërkesa është në përputhje me politikat komunale dhe do të realizohet edhe gjatë viteve 2026 si dhe në vitet vijuese 2027-2028.
30. Rruga e Hasallarëve të lidhet me rrugën për në Gorancë dhe Krivenik	Sadat Hasallari	Aprovuar	Kërkesa është në përputhje me politikat komunale dhe do të realizohet në vitin 2026, ky propozim është miratuar në Kuvend Komunal.
31. Vendosija e murit mbrojtës tek rruga “Veteranët e UÇK-së”	Sadat Hasallari	Aprovuar	Kërkesa është në përputhje me politikat komunale dhe do të realizohet në vitin 2026, ky propozim është miratuar në Kuvend Komunal.

SUBVENCIONE

Kërkesat, sugjerimet, idetë e parashtruara në konsultim	Emri i personit/organizatës	Statusi i kërkesës	Përgjigja dhe arsyeshmëria e komunës/grupit punues
Rehabilitimi i anëtarëve të Handikos në Banjë	Nerxhivane Berisha – Kryetare e Shoqatës “Handikos”	Aprovuar	Kërkesa është në përputhje me politikat komunale dhe do të realizohet edhe gjatë vitit 2025 si dhe në vitet vijuese
Subvencionimi i fermerëve për mbjelljen e luleve apo bimëve	Muhamed Suma	Adresuar	Kërkesa është në përputhje me politikat komunale dhe do të shqyrtohet mundësia e realizimit me anë të bashkëfinancimit apo donatorëve lokal.
Të vendosen shtylla elektrike në fshatin Krivenik, konkretisht deri te tokat ku i mbajnë bletët	Fesja Thaçi	Adresuar	Komuna do të adresojë këtë kërkesë te Institucionet kompetente
Sigurimi i ujit të pijes edhe gjatë sezonës së verës	Igballe Bushi	Aprovuar	Do të shqyrtohet realizimi i kësaj kërkesë gjatë vitit aktual duke u bazuar në mundësitë buxhetore
Përkrahje me subvencion apo bursa	Ardita Suma	Aprovuar	Për çdo vit Komuna ndan bursa për studentë nëpër Fakultetet Shtetërore. Përveç bursave ka studentë të cilët përkrahen varësisht prej natyrës së kërkesave tyre.
Pajisja e gjithë klasëve me tabela digjitale dhe pajisja e mësimdhënësve me Laptop-a	Ahmet Krasniqi	Aprovuar	Kjo kërkesë është në realizim e sipër për vitin aktual si dhe do të bëhet pajisja me pajisje të IT-së për mësimdhënësit në vitet vijuese.

MALLRA & SHËRBIME			
Kërkesat, sugjerimet, idetë e parashtruara në konsultim	Emri i personit/organizatës	Statusi i kërkesës	Përgjigja dhe arsyeshmëria e komunës/grupit punues
Furnizimi me klima në SHFMU “Kështjella e Diturisë”	Bujamin Berisha	Adresuar	Do të shqyrtohet realizimi i kësaj kërkesë duke u bazuar në mundësitë buxhetore
Një vizitë në Prekaz	Nerxhivane Berisha – Kryetare e Shoqatës “Handikos”	Aprovuar	Do të shqyrtohet realizimi i kësaj kërkesë gjatë vitit aktual duke u bazuar në mundësitë buxhetore
Ofrimi i shërbimeve të fizioterapisë 1-2 herë në javë	Nerxhivane Berisha – Kryetare e Shoqatës “Handikos”	Aprovuar	Nga Ministria e Shëndetësisë na kanë aprovuar 13 pozita të reja pune për vitin 2026, ndër ta është edhe Fizioterapeuti.
Vendosja e shportave të mbeturinave	Këshilli i fshatit Gorancë	Aprovuar	Kërkesa është në përputhje me politikat komunale dhe do të realizohet në vitin 2026
Ndryshimi i pusetave nga varrezat dhe nëpër fshat	Këshilli i fshatit Gorancë	Aprovuar	Kërkesa është në përputhje me politikat komunale dhe do të realizohet në vitin 2026
Mirëmbajtja e parkut të AMF	Këshilli i fshatit Gorancë	Aprovuar	Ky propozim do të implementohet gjatë vitit 2026
Mundësimi i transportit publik në fshatin Gorancë	Këshilli i fshatit Gorancë	Refuzuar	Kërkesa është në përputhje me politikat komunale megjithatë për shkak të buxhetit tejet të limituar Komuna nuk mundet të trajtojë këtë çështje
Të mundësohet të bëhet biokimia e gjakut dhe tumormarkerat, Së paku një herë në javë të vij një Radiolog	Drita Prenku	Adresuar	Do të shqyrtohet realizimi i kësaj kërkesë duke u bazuar në mundësitë buxhetore dhe do të adresohen kërkesat nëpër Institucione tjera relevante
Sigurimi i transportit prej në Kaçanik deri në Han të Elezit	Myvedete Vila	Adresuar	Kjo kërkesë do të adresohet tek Kompania e Autobusave që të shtohen edhe linja të reja për këto destinacione
Pajisje e nxënësve me uniforma	Lumturije Bushi	Adresuar	Do të shqyrtohet realizimi i kësaj kërkesë duke u bazuar në mundësitë buxhetore dhe do të diskutohet edhe me Këshillin e Prindërve
Përforcimi i Internetit mbas furnizimit me tabela digjitale	Basri Dernjani	Aprovuar	Do të rregullohet gjatë vitit 2026
Hapja e një fondi për mbledhjen e mjeteve financiare për nxënësit e dalluar	Habib Thaçi	Adresuar	Do të shqyrtohet mundësia ligjore e realizimit të kësaj kërkesë
Shtimi i vizatave mjekësore nëpër shkolla	Shenasi Dernjani	Aprovuar	Në bashkëpunim me DSHMS dhe DKA, do të shtohen vizitat dhe kontrollat e nxënësve nëpër shkolla.
Vendosja e shenjave për kufizim të shpejtësisë, ndalim i parkingut etj	Mirvet Kalisi Mevludin Kuka	Aprovuar	Kërkesa është në përputhje me politikat komunale dhe do të realizohet në vitin 2026
Mungesa e shenjëzimit dhe shenjave për këmbësor tek Furra “Mali”	Mërgim Shkreta	Aprovuar	Kërkesa është në përputhje me politikat komunale dhe do të realizohet në vitin 2026

Vendosja e pengesave në rrugën e Lagjes së Re	Nehat Berisha	Aprovuar	Kërkesa është në përputhje me politikat komunale dhe do të realizohet në vitin 2026
Vendosja e pasqyrave në Lagjen e Re	Sadat Hasallari	Aprovuar	Kërkesa është në përputhje me politikat komunale dhe do të realizohet në vitin 2026
Të trajtohet një pjesë e mbetur te rruga “ Veteranët e UÇK-së”	Xhemil Ballazhi	Aprovuar	Kërkesa është në përputhje me politikat komunale dhe do të realizohet në vitin 2026
Pastrimi i përroit nëntokësor	Visar Hasallari	Aprovuar	Kërkesa është në përputhje me politikat komunale dhe do të realizohet në vitin 2026
Vendosja e pengesave rrugore kah Lagja e Re dhe kah fabrika e suxhikut	Visar Hasallari	Aprovuar	Kërkesa është në përputhje me politikat komunale dhe do të realizohet në vitin 2026
PYETJE/KËRKESË PËR INFORMACION/SUGJERIME			
Kërkesat, sugjerimet, idetë e parashtruara në konsultim	Emri i personit/organizatës	Statusi i kërkesës	Përgjigja dhe arsyeshmëria e komunës/grupit punues
Shqetësim qentë endacak	Bujar Bushi	Adresuar	Komuna ka adresuar këtë shqetësim në KKSB
A është planifikuar rregullimi i nxemjes në Sallën e Sportit në fshatin Paldenicë	Bujamin Berisha	Aprovuar	Do të rregullohet gjatë vitit 2026
Çka është planifikuar në projektin e tregut?	Igballe Bushi	Aprovuar	Hapësira e tregut ditor, do të shfrytëzohet edhe për panairë si dhe rekreacion
Bartja e shpenzimeve të pompës së rrymës në Sudonec	Këshilli i fshatit Gorancë	Adresuar	Komuna do të adresoj këtë kërkesë te Institucionet kompetente
Të zëvendësohen shtyllat e drurit me të betonit te rruga “Pavarësia”	Këshilli i fshatit Gorancë	Adresuar	Komuna do të adresoj këtë kërkesë te Institucionet kompetente
Të përforcohet rrjeti i telefonisë mobile të Vala apo Ipko	Këshilli i fshatit Gorancë	Adresuar	Komuna do të adresojë këtë kërkesë te Institucionet kompetente
Sa prej propozimeve të debateve të kaluara nga fermerët janë pjesë e buxhetit 2026	Muhamed Suma	Pjesërisht e pranuar	Kërkesat janë në përputhje me politikat komunale megjithatë për shkak të buxhetit tejet të limituar Komuna nuk mundet të trajtojë këtë çështje plotësisht dhe t'i aprovoj të gjithë kërkesat nga Fermerët pasi që ka shumë kërkesa për mbështetje edhe në fusha tjera
Në shumën e ndarë prej 30,000.00 € në drejtorinë e Bujqësisë ku jeni bazuar në ndarjen e kësaj shume?	Muhamed Suma	Aprovuar	Në bazë të kërkesave të fermerëve, kjo shumë do të dedikohet vetëm për pajisje bujqësore mirëpo mbështetja e këtij Sektori nuk do të kufizohet vetëm nga kjo shumë.
Propozoj fermerët të mbështeten edhe në vitet vijuese me pajisje, ligjërata të ndryshme.	Muhamed Suma	Aprovuar	Kërkesa është në përputhje me politikat komunale dhe do të realizohet në vitin 2026
Subvencionimi i kulturave tjera (blegëtori, pemëtari etj)	Kushtrim Loku	Aprovuar	Subvencionimi për pemëtari është realizuar gjatë vitit aktual dhe do të vazhdoj edhe në vitet tjera për kultura apo sektorë të tjerë.
Kërkesë informacioni mbi kompensimin e dëmeve të shkaktuara nga breshërit	Kushtrim Loku	Adresuar	Komuna ka themeluar 1 Komision dhe 1 Nënkomision për evidentimin e dëmeve të shkaktuara nga breshërit. Komisioni përkatës ka evidentuar të gjithë dëmet në teren në bazë të

			kërkesave dhe dokumentacioneve të dorëzuara. Më pas, të gjitha lëndët janë dorëzuar në AME. Megjithatë, ne si Komunë nuk kemi të drejtë në kompensime të dëmeve nga fatkeqësitë natyrore.
Caktimi i një pike grumbulluese për ujin me ramje të lirë për ujitje	Servet Suma	Adresuar	Grupi Punues do të shqyrtoj mundësinë e realizimit të këtij propozimi
Shkrutimi i kohës së pritjes për analiza	Vahide Shkreta	Adresuar	Komuna do të adresojë këtë kërkesë te Institucionet kompetente
Sigurimi i kuadrit për leximin e analizave të Ultrazërit në QKMF	Igballe Bushi	Adresuar	Kemi mungesë të kuadrit por do të shqyrtohet mundësia përmes Marrëveshjeve me biznese ose OJQ për rekrutim të stafit profesional së paku 2 herë në muaj
Aplikimi i mësimi gjithëditor nëpër shkolla	Basri Dernjani	Aprovuar	Kjo kërkesë do të realizohet kur të ndërtohet shkolla në Lagjen e Re. Projekt i cili është miratuar në Kuvend Komunal për vitet 2026-2028. Pas përfundimit të çështjes së shpronësimit.
Organizimi i trajnimeve rreth përdorimit të tabelave digjitale si dhe testimi të bëhet online	Fitim Thaçi	Aprovuar	Kjo kërkesë do të realizohet në bashkëpunim me Project of Kosova
A keni parashikuar shtimin e një drejtimi të ri në shkollën e mesme	Shenasi Dernjani	Refuzuar	Në bazë të Udhëzimit të ri Administrativ duhet të jetë ose gjimnaz ose shkollë profesionale. Nuk mundemi ta shëndërrojmë gjimnazin në shkollë profesionale.
Ndërrimi i shtyllave elektrike	Arafat Luri	Adresuar	Kjo kërkesë është adresuar në Institucionet kompetente dhe përgjegjëse. Do të ripërsëriten këto kërkesa.
Propozoj të formohet një komision për të kontrolluar gjendjen e rrugës të shemta që çon për në Gorancë, me qëllim të parandalimit të vërshimeve apo rreziqeve tjera	Sadik Rexhallari	Adresuar	Kjo kërkesë do të adresohet në Institucionet kompetente dhe përgjegjëse.
Kërkesë për informacion për shkollën në Lagjen e Re	Visar Hasallari	Adresuar	Fondi për mbledhjen e të hollave e ka afruar shumën e cila duhet të paguhet për shpronësim. Pastaj kjo parcelë do të kalojë në pronësi Komonale dhe Shkolla do të ndërtohet nga Ministria e Arsimit.
Te xhamia e Lagjes së Re, zakonisht frekuentohet nga Sirianët.	Visar Hasallari	Adresuar	Kjo çështje është diskutuar në mbledhjet e KKS-së dhe do të diskutohet përsëri për të shtuar sigurinë në atë zonë.
Si është mundësia me u rrit subvencionimi dhe përkrahja e rinisë	Visar Hasallari	Aprovuar	Buxheti i ndarë për Subvencione dhe Transfere është rritur për vitin 2026. I njëjti është miratuar në Kuvend Komunal.
Shtirimi i shtyllave të ndriçimit publik prej te varrezat e Dëshmorëve deri në fshatin Pustenik	Halim Ballazhi	Adresuar	Kjo kërkesë do të adresohet në Institucionet kompetente dhe përgjegjëse.

6. KONKLuzionet

Procesi i dëgjimeve buxhetore për Draft Buxhetin Komunal 2026-2028 ka dëshmuar rëndësinë e pjesëmarrjes së gjerë të qytetarëve/eve dhe grupeve të interesit në përcaktimin e prioritetëve të komunës. Pjesëmarrja aktive ka mundësuar që nevojat, shqetësimet dhe propozimet e banorëve/eve të reflektohen në dokumentin buxhetor, duke garantuar një proces transparent dhe gjithëpërfshirës.

Nga dëgjimet u konstatua se prioritetet kryesore të komunitetit mbeten përmirësimi i infrastrukturës rrugore dhe kanalizimeve, furnizimi me ujë të pijes, ndriçimi publik, përmirësimi i shërbimeve shëndetësore dhe arsimore, si dhe mbështetja e sektorit të bujqësisë. Shumë nga këto kërkesa janë përfshirë në buxhetin e vitit 2026, ndërsa të tjera janë planifikuar për t'u realizuar në periudhën 2027–2028 ose do të adresohen te institucionet përkatëse.

Në të njëjtën kohë, u evidentua se kufizimet buxhetore mbeten sfidë kryesore për komunën, duke pamundësuar përfshirjen e të gjitha kërkesave. Megjithatë, përmes prioritizimit dhe bashkëpunimit me Ministrinë e linjës, Donatorët dhe Partnerët e tjerë, komuna do të vazhdojë të kërkojë mënyra shtesë financimi për të realizuar sa më shumë projekte të propozuara.

Hapat e ardhshëm do të përfshijnë:

- Zbatimin e projekteve kapitale të planifikuara për vitin 2026 sipas listës së miratuar në Kuvendin Komunal,
- Monitorimin dhe raportimin e rregullt të realizimit të projekteve për të siguruar transparencë dhe llogaridhënie,
- Vazhdimin e bashkëpunimit me komunitetin për të siguruar që kërkesat e qytetarëve/eve të jenë gjithmonë në qendër të vendimmarrjes,
- Përcaktimin e një plani afatmesëm për realizimin e kërkesave të mbetura, të cilat për arsye buxhetore nuk kanë mundur të përfshihen në këtë cikël,
- Intensifikimin e përpjekjeve për të siguruar mbështetje financiare nga donatorë vendorë dhe ndërkombëtarë.

Në përfundim, ky proces ka treguar se dëgjimet buxhetore janë mekanizëm i domosdoshëm për forcimin e demokracisë lokale, rritjen e transparencës dhe ndërtimin e një buxheti që i përgjigjet realisht nevojave të qytetarëve të Komunës së Hanit të Elezit.